VENDIM
Nr.43, datë 15.6.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN
"PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NGA SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe të nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 126 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

~~1.~~1. Në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", miratuar me vendimin nr.11, datë 25.2.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

~~(a)~~a) Në nenin 21, paragrafi 2, shtohet shkronja "i" me përmbajtjen e mëposhtme:

" i... listën e agjentëve të tij apo ndryshime të saj.".

~~(b)~~b) Në nenin 22, paragrafi 2 ndryshon si më poshtë:

"...2. Agjenti për ushtrimin e veprimtarisë financiare të transferimit të parave merr miratimin e Bankës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur si agjent është një bankë ose degë e bankës së huaj e licencuar nga Banka e Shqipërisë.".

~~2.~~2. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

~~3.~~3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

~~4.~~4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

Formatted: Bullets and Numbering

Formatted: Bullets and Numbering

Formatted: Bullets and Numbering